



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË ZYRËS SË KRYEMINISTRIT PËR VITIN 2024

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Kryeministrit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Zyrës së Kryeministrit (ZKM), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Zyrës së Kryeministrit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të ZKM kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretar i Përgjithshëm, Zyra e Kryeministrit të Kosovës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretar i Përgjithshëm, Zyra e Kryeministrit të Kosovës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Sekretar i Përgjithshëm, Zyra e Kryeministrit të Kosovës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Zyrës së Kryeministrit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Zyrës së Kryeministrit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Zyrës së Kryeministrit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Zyrës së Kryeministrit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Zyrës së Kryeministrit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Ky raport ka rezultuar me pesë rekomandime, prej tyre katër janë rekomandime të reja, dhe një është i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunalitë në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 262,424€. Realizimi në këtë kategori ishte 82%. Ato kishin të bënin me furnizim për zyrë, pajisje nën 1000€, dhe mbi 1000€, dreka zyrtare, shërbime kontraktuese tjera etj.

Çështja A1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës financiare nr. 01/2013 - Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Gjatë vitit 2024 ishin paguar dhe regjistruar shpenzime në kategori ekonomike joadekuate si në vijim:

- Zyra e kryeministrit ka shpenzuar 30,000€, nga kategoria mallra dhe shërbime për kontratën “Furnizim me Vitrinë”, që për nga natyra i përket investimeve kapitale. Kjo ka rezultuar me keq klasifikim të shpenzimeve në PFV, duke mbivlerësuar mallrat dhe shërbimet dhe nënvlerësuar investimet kapitale; dhe
- Agjencia e Statistikave të Kosovës ka realizuar një pagesë në vlerë prej 10,013€ për lëndën urdhër përmbarim, bazuar në Aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe të Apelit për një ish zyrtar të pensionuar të kësaj agjencie, të ekzekutuar nga Thesari nga kategoria ekonomike “Mallra dhe Shërbime”. Sipas natyrës së tyre, këto shpenzime duhej të klasifikoheshin në kategorinë ekonomike “Paga dhe mëditje”. Kjo ka rezultuar me keq klasifikim të shpenzimeve në PFV, duke mbivlerësuar mallrat dhe shërbimet dhe nënvlerësuar Pagat dhe mëditjet.

Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve ishte rezultat i planifikimit jo të duhur ekonomik. Po ashtu, ishte ndikuar nga ekzekutimi i pagesave përmes Thesarit sipas vendimeve të Gjykatës.

Ndikimi Pagesat e kryera nga kategoritë joadekuate të shpenzimeve ndikojnë në raportimin financiar jo të drejtë, si dhe në mbivlerësimin /nënvlerësimin e kategorive të shpenzimeve.

Rekomandimi A1 Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me Kryeshefin e ASK-së duhet të sigurojnë që të gjitha shpenzimet të planifikohen dhe realizohen sipas kategorive ekonomike të përcaktuara në planin kontabël, në përputhje me rregullat financiare, me qëllim që raportimi financiar të jetë i saktë dhe i besueshëm në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A2 - Mos përdorimi i modulit në sistemin e prokurimit elektronik, për menaxhimin e kontratave dhe vlerësimit të performancës së kontraktuesve

Gjetja Rregullorja 01/2022 për Prokurimin Publik, neni 70.2 përcakton që vlerësimi i performancës së kontraktuesve do të bëhet nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, përmes të modulit për vlerësim nga menaxherët e kontratës, gjatë dhe pas përfundimit të implementimit të kontratave publike. Po ashtu, neni 70.24.f. përcakton se menaxheri i kontratës është përgjegjës për përgatitjen, mbajtjen dhe arkivimin e të gjithë regjistrave të menaxhimit të kontratës në këtë modul.

Në katër raste është konstatuar se menaxherët e kontratave nuk kanë përdorur modulën për menaxhimin dhe vlerësim të performancës në sistemin e prokurimit elektronik, siç kërkohet me rregullore. Këto raste kanë të bëjnë me "Shërbime të përkthimit, Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative, Shërbime të shtypjes në alfabetin Brail", dhe "Furnizim me vitrina të ndryshme.

Kjo situatë ka rezultuar si pasojë e mungesës së njohurive të nevojshme të menaxherëve të kontratave për përdorimin e modulit të dedikuar si dhe për shkak të mungesës së mbikëqyrjes dhe mbështetjes së duhur nga ana e zyrës së prokurimit.

Ndikimi Mungesa e vlerësimit të performancës së kontratës përmes sistemit të prokurimit elektronik, ndikon në menaxhimin jo efektiv dhe transparent të kontratave si dhe nuk ofron mundësi që menaxhmenti në kohë reale të marr informata mbi performancën dhe realizimin e kontratës.

Rekomandimi A2 Sekretari i përgjithshëm duhet të sigurojë që menaxherët e kontratave të bëjnë administrimin dhe implementimin e kontratave nëpërmjet modulit për menaxhim të kontratave në sistem të prokurimit elektronik për të siguruar vlerësim adekuat të performancës së kontraktuesve dhe informata mbi progresin e implementimit të kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 348,139€, pasurive jokapitale është 791,688€, si dhe e stoqeve 202,075€.

Çështja A3 - Mos regjistrimi i pagesave të investimeve kapitale në regjistrin e pasurive

Gjetja

Regullorja e MF nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, neni 6 Regjistri i pasurive jo financiare paragrafi 3, Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria"

Pasuritë kapitale të prezantuara në raportin vjetor financiare, ishin nënvlerësuar për 49,944€, për shkak të mos regjistrimit të dy pagesave në regjistrin e pasurive kapitale SIMFK. Pagesat kishin të bënin me Pajisje për shkrim Brail, dhe Furnizime të ndryshme të IT-së.

Komunikimi jo i duhur në mes të zyrtarëve përgjegjës ka qenë shkak i kësaj mangësie

Ndikimi

Mos regjistrimi i pasurive kapitale ndikon që vlera e pasurive kapitale të paraqitura në raportin vjetor financiar të jetë e nënvlerësuar.

Rekomandimi A3

Sekretari i Përgjithshëm duhet të forcojë mekanizmat e kontrollit të brendshme për të evituar nënvlerësimin e pasurive, si dhe të siguroj që çdo pasuri e blerë të jetë prezantuar saktë dhe në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.3 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2024, ishte 217,687€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2025. Krahasuar me vitin 2023 detyrimet ishin rritur për 121,529€.

Çështja B1 - Vonesa në pagesën e obligimeve

Gjetja Neni 39.1 i LMFPP përcakton që: ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Nga mostrat e testuara në katër raste në vlerë 49,903€, pagesat e faturave të pranuar nuk ishin paguar brenda afatit të lejuar ligjor prej 30 ditëve. Vonesat ishin prej 5 deri në 37 ditë.

Kjo praktikë ishte raportuar edhe në raportet e viteve të kaluara dhe si e tillë, po përsëritet vit pas viti për shkak të dobësive në kontrollet e brendshme sa i përket pagesës së faturave me kohë.

Ndikimi Tejkalimi i afatit ligjor për pagesën e obligimeve mund ta bëjë ZKM-në subjekt të padive nga operatorët ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/përmbartimore apo obligime për vitin vijues.

Rekomandimi B1 Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj që të gjitha faturat e pranuar të paguhen brenda afatit të përcaktuar ligjor prej 30 ditësh pas pranimit të faturave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.4 Detyrimet kontigjente

Pasqyra e detyrimeve kontigjente në fund të vitit 2024, ishte 26,192€.

Çështja A4 - Shpalosje jo e saktë e detyrimeve kontigjente

Gjetja Neni 6 i rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, përcakton se Organizatat Buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jofinanciare.

Agjencia e Statistikave të Kosovës kishte shpalosur detyrime kontigjente në vlerë prej 24,713€ gabimisht pasi që për këto lëndë ishin ekzekutuar pagesat. Këto pagesa kishin të bënin me vendime gjyqësore të ekzekutuara nga Thesari.

Kjo ka ndodhur si rezultat i kontroleve të dobëta nga ana e zyrës së financave lidhur me mbajtjen e evidencave të sakta dhe raportimin e saktë të tyre në PVF.

Ndikimi Prezantimi jo i plotë i detyrimeve kontigjente ndikon që shfrytëzuesit e PVF-ve të mos informohen drejtë dhe saktë.

Rekomandimi A4 Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me Kryeshefin Ekzekutiv të Agjencisë të Statistikave të Kosovës (IASK) duhet të sigurojë që detyrimet kontigjente të prezantohen në vlera të sakta si dhe të mbahen evidenca të plota lidhur me çështjet që janë në procedurë gjyqësore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	22,395,572	23,342,873	18,757,533	9,462,714	10,854,913
Grante Qeveritare - Buxheti	21,823,572	21,863,186	18,411,390	8,639,180	10,066,903
Financimi përmes huamarrjes	572,000	572,000	0	0	0
Të bartura nga viti i kaluar	0	0	0	0	10,901
Donacionet vendore	0	19,612	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	888,075	346,143	823,534	777,110

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 947,301€. Ky ndryshim ishte si rezultat i vendimeve të Qeverisë për 39,614€, dhe donacionet në vlerë 907,687€.

Në vitin 2024, ZKM ka shpenzuar 80% të buxhetit përfundimtar ose 18,757,533€, me një rritje për 20% në krahasim me vitin 2023.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	22,395,572	23,342,873	18,757,533	9,462,714	10,854,913
Pagat dhe mëditjet	4,608,996	4,069,416	4,061,360	3,765,146	3,960,147
Mallrat dhe shërbimet	11,047,664	11,309,763	9,295,877	3,981,589	3,122,374
Komunalitë	93,225	93,550	39,343	24,733	83,831
Subvencionet dhe transferet	6,605,687	7,770,779	5,278,070	1,353,532	3,408,425
Investimet Kapitale	40,000	99,366	82,882	337,714	280,135

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje, në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar me vendim të Qeverisë për 539,580€. Realizimi në këtë kategori ishte 100%.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime, në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 262.099€. Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte vetëm 82% e buxhetit final.
- Buxheti final për komunalitet në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 325€, ndërsa realizimi në këtë kategori ishte 42%. Mosrealizimi i buxhetit ishte për shkak se këto shpenzime ishin planifikuar për t'u shpenzuar nga agjencitë e ZKM (përfshirë ASK-në) duke qenë se shfrytëzojnë të njëjtin objekt, derisa pagesa ishte kryer nga ZKM.
- Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte rritur për 1,165,092€ krahasuar me buxhetin fillestar, ndërsa realizimi në këtë kategori ishte 68%. Kjo rritje erdhi si rezultat i vendimeve të Qeverisë, që lidhen me zbatimin e masës 1.7 - Skema e Granteve për Zanate në kuadër të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, realizimin e projekteve në bashkëpunim me trupat e OKB-së, si dhe për harmonizime të brendshme buxhetore.
- Buxheti final për investime kapitale ishte rritur për 59,366€ në raport me buxhetin fillestar, ndërsa realizimi në këtë kategori ishte 83%. Kjo rritje ishte kryesisht për të mundësuar realizimin e projekteve që përfshinin pajisje të dedikuara për sallën e mbledhjeve të Qeverisë, si dhe blerjen e pajisjeve ndihmëse për personat me aftësi të kufizuara dhe personat e verbër.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat e realizuara nga ZKM në 2024 ishin në vlerë 2,582€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga shitja e pasurisë.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	10,000	10,000	2,582	1,435	6,890,735
Të hyrat jo tatimore	10,000	10,000	2,582	1,435	6,880,235
Të hyrat tjera	0	0			10,500

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2023 të ZKM-së ka rezultuar në 2 rekomandime kryesore. ZKM kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, një rekomandim është mbyllur ndërsa, një nuk ishte zbatuar siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve).


Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj që të nxjerrën urdhërblerjet para se të pranohen mallrat dhe faturat në mënyrë që të respektohen procedurat dhe të evitohen blerjet e pa kontrolluara.		Nuk është i aplikueshëm më
2.	Obligimet e papaguara	Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj që të gjitha faturat e pranuar të paguhen brenda afatit të përcaktuar ligjor prej 30 ditësh pas pranimit të faturave.	Në kuadër të auditimit të ZKM çështja e njëjtë ka rezultuar edhe në vitin 2024	Nuk është adresuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Jusuf Kryeziu, Drejtor i Auditimit



Arta Kryeziu, Udhëheqëse e ekipit



Abdurrahmon Bërbatovci, Anëtar i ekipit



Leonora Hasani, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve	<p>Pagesa është kryer te Përmbaruesi Arben Gashi ne llogarine Gashi & Associates L.L.C. Prishtine, jo te zyrtari i pensionuar .</p> <p>Përmbaruesi është SUBJEKT JURIDIK dhe është jo e ligjshme te kryhen ne kategorinë paga dhe shtesa për subjekte juridike.</p> <p>Gjithashtu mungesa e mjeteve ne kategorinë paga dhe shtesa do te pamundësonte pagesën nga kategoria paga dhe shtesa .</p> <p>Bashkëngjishim shkresën zyrtare qe kemi kërkuar mjete nga ZKM për mbulimin e shpenzimeve te stafit te ASK-ës ne kategorinë paga dhe shtesa si dhe komunikimin me e-mail dërguar ne ZKM dhe Thesar për mungese te mjeteve.</p> <p>ZKA siguron qe shpenzimet janë ne përputhje me rregullat financiare te Thesarit, dhe kjo çështje mos të përfshihet ne raportin përfundimtar .</p>	Gjetja dhe rekomandimi mbetet i pandryshuar.

Shpalosje jo e saktë e detyrimeve kontigjente	ASK sipas komunikimeve me zyrtar financiarë të institucioneve tjera, na është rekomanduar që lendet përbarimore edhe pse janë ekzekutuar të paraqiten si detyrime kontigjente . Ne të kaluarën lendet e ekzekutuara, ASK nuk i ka paraqitë si detyrime kontigjente. ZKA i ASK-ës do të siguroj që detyrimet kontigjente do të prezantohen sipas rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.	Gjetja dhe rekomandimi mbetet i pandryshuar.
---	--	--

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.